



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES



MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESELDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga takimi i parë publik me qytetarë për Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës së Shtimes, Dr. Qemajl Aliu për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, e mbajtur më 27 qershori 2025, në ora 15:00, në Sallën e Kuvendit.

Në takim morën pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Dr. Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit Adnan Ademi, Shefja e Kabinetit, Anita Kurti, drejtorë të drejtorive komunale si dhe qytetarë.

Takimi u hap nga Shefja e Kabinetit, Anita Kurti, e cila përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e këtij takimi si një formë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët. Ajo nënvozoi se transparenca dhe llogaridhënia janë vlera thelbësore për qeverisjen lokale, dhe se raportimi i punës është një praktikë e domosdoshme për rritjen e besimit qytetar në institucionet komunale.

Pas fjalës hyrëse, u shfaq një video prezantuese, e përgatitur nga kabineti i kryetarit, në të cilën u paraqit një përbledhje vizuelle e punës gjashtëmujore të Komunës së Shtimes. Videoja përfshinte projekte të realizuara, investime kapitale, punë infrastrukturore dhe shërbime të ofruara për qytetarët gjatë periudhës Janar-Qershori 2025.

Pas shfaqjes së videos, Kryetari Dr. Qemajl Aliu mori fjalën për të sqaruar më tej detaje dhe për të ofruar sqarime shtesë për projektet e prezantuara.

Kryetari, Dr.Qemajl Aliu: Të nderuar qytetarë dhe të gjithë të pranishëm, ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe interesimin tuaj në këtë takim. Është nder dhe përgjegjësi për mua të ndaj me ju punën dhe angazhimin tonë gjatë gjashtë muajve të fundit. Ky raportim është një dëshmi e përkushtimit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës dhe përmirësimin e jetës së çdo qytetari.

Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi filluar punimet për objektin e Entit Special, me një sipërfaqe prej 6,811.24 metra katrorë dhe një investim prej 6.3 milionë euro. Ky projekt është shumë i rëndësishëm për ne, sepse do të na ndihmojë të rrisim kapacitetet dhe të përmirësojmë shërbimet për qytetarët tanë.

Po ashtu, kemi vendosur gurthemelin për Qendrën e kujdesit parësor "Dr.Vezir Bajrami", një objekt i ri me sipërfaqe prej 3,000 metra katrorë dhe investim prej 2.4 milionë euro. Kjo qendër do

të ofrojë analiza të avancuara, shërbime moderne në radiologji, trajtim stomatologjik dhe standarde të reja në kujdesin shëndetësor. Ky është një hap i madh për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në komunën tonë.

Një nga lajmet më të mira që secili prej nesh e ka pritur, dhe që ka qenë zotim i yni, është objekti i ndërtuar përpara komunës, i cili deri tani ka qenë në shërbim të askujt. Kemi filluar procedurat e rrënimit për shkak të bizneseve që gjenden aty, dhe kemi lënë që ky proces të nisë në shtator, pasi të shkojë mërgata.

Këtu është fillimi i Unazës së Madhe. Bashkë me ministrin Liburn Aliu kemi gjithë makineritë që operojnë në fshatrat Llanishtë, Petrovë, Reçak dhe Belincë. Qytetarët që vijnë nga ato zona e dinë që kanë qenë të dëmtuara nga pluhuri dhe zhurma. Ne kemi gjetur një zgjidhje përmes këtij projekti, që e kemi quajtur "Unaza e Madhe", një zgjidhje prej 3.4 kilometresh, ku vetëm faza e parë kushton 1.5 milion euro. Po punohet me një dinamikë të pëershpejtuar dhe besoj që deri në shtator do të hapet.

Objekti i komunës, siç e keni parë, ndërtimi është drejt përfundimit, bodrumi dhe tre katet janë bërë, dhe së shpejti do të nis hyrja dhe ndërtimi i oborrit. Ky projekt, me vlerë 2.5 milion euro, do ta zgjidhë përfundimisht çështjen e shtëpisë së qytetit tonë, komunës dhe administratës.

Ndërtimi i tribunave ka marrë formë; jemi dëshmitarë që po punohet edhe në fazën e fundit. Sipas operatorit, në fillim të shtatorit do të kemi një stadium modern ashtu siç i ka hije qytetit tonë. Më herët kemi investuar mbi 250 mijë euro në dysheme dhe në bar, ndërsa tani po i shtohet edhe investimi prej 2.4 milion euro, që do ta mbyllë përfundimisht çështjen e stadiumit.

Ajo që quhet "Shtëpia e Përshpirtshme" ose "Qendra Rinore" është një nga objektet më të vlefshme në Komunën e Shtimes, e cila ka qenë e shkatërruar dhe e padefinuar për ndonjë qëllim. Me një investim që po bëhet me bashkëfinancim nga komuna e Shtimes dhe Ministria e Kulturës në vlerë mbi 600 mijë euro. Në fund të gushtit kjo qendër do të vihet në shërbim të të gjitha shoqatave kulturore-artistike, shoqatave të UÇK-së dhe të sportit. Përveç funksionalizimit, do ta mirëmbajmë dhe do të jetë një objekt plot gjallëri për të rinjtë tanë.

Çerdhja e dytë në qytetin e komunës së Shtimes ka qenë një objekt i braktisur dhe i dëmtuar, pothuajse jashtë funksionit. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit kemi shtuar mbi 130 mijë euro, dhe siç e kemi parë para një muaji, ajo është finalizuar. Qyteti tashmë ka dy çerdhe që do t'i mbulojnë nevojat, dhe katër çerdhe të tjera janë në proces: në Muzeqinë kemi funksionalizuar një, në Petrovë jemi në ndërtim e sipër, në Godanc është përfunduar dhe pritet finalizimi, ku në shtator besoj se do të nisë puna si dhe po punohet në Carralevë që brenda këtij viti të finalizohet.

Për fillimin e punimeve në ndërtimin e çerdhes në Petrovë siç edhe e përmenda ky projekt ka vlerën prej 1 milion e 157 mijë euro. Kjo çerdhe do të jetë e madhe dhe bashkëkohore për fëmijët e Petrovës, përkatësisht të Mollopolcit dhe një pjesë të Reçakut.

Fshati më i madh në komunën tonë, Petrova, ka qenë në gjendje të rëndë me objektin e shkollës. Tani po ndërtojmë një aneks shtesë dhe objekti po rinovalohet tërësisht. Salla tashmë është funksionalizuar, ashtu si edhe oborri. Me këtë ndërhyrje, në vlerë rrëth 1.5 milion euro, fshati Petrovë do të ketë një infrastrukturë shkollore bashkëkohore.

Për sa i përket sallës së sportit: për hir të së vërtetës, ajo ka qenë e ndërtuar më herët që mos t'i hyjmë në hak askujt por nuk ishte funksionalizuar. Ka pasur nevojë për investime me dhjetëra e qindra mijëra euro për ta bërë funksionale dhe në shërbim të fëmijëve të asaj shkolle. Këtë vit, ne e kemi përfunduar.

Renovimi i tri shkollave: pasi kemi ndërhyrë më parë në dy shkolla në “Naim Frashëri” dhe “Emin Duraku” (lart), këtë herë kemi filluar renovimin e plotë të shkollës filllore “Emin Duraku” (poshtë), “Hasan Prishtinës”, si dhe të shkollës profesionale. Me nga 350 mijë euro për secilën, ky fond prej gjithsej 1.3 milion euro, përmes fondit të efikasitetit (kreditor i yni), do t'i sjellë këtyre tri objekteve infrastrukturë moderne.

Investimi në pajisje laboratorike për shkollën e Carralevës dhe të Petrovës ka një vlerë prej 82 mijë euro. Këto dyja janë pjesë e afro dhjetëra laboratorëve që kemi ndërtuar gjatë këtyre tri viteve të qeverisjes sonë.

Ndërtimi i çerdhes në Godanc është në fazën përfundimtare. Siç e theksova, kemi përgatitur edhe kuadrin dhe presim që në shtator t'a funksionalizojmë çerdhen.

Rregullimi i asfaltit në rrugën “12 Qershori” ose siç e quajmë ndryshe, “Unaza e Vogël” në drejtim të Ferizajt përfshin gjithashtu rrugën “William Walker” dhe vetë rrugën “12 Qershori” (ose “rruga e Bllacalive”, siç njihet). Kjo lidhje vazhdon me rrëthrrötullimin nga Ferizaj për në Shtime dhe më tej me segmentin tjetër të unazës. Ky është një investim me vlerë mbi gjysmë milioni euro.

Në projektet infrastrukturore përfshihet edhe asfaltimi i rrugës “Mehdi Korani”. Kush është nga fshati Petrovë e di, nga çeshmja e Nazim Hajdarëve deri te shkolla filllore ka qenë rrugë e arave që lidh të gjitha lagjet e Petrovës. Ky investim kap vlerën prej rrëth 300 mijë eurosh, me mbi 2 km gjatësi dhe përfshin një urë që ka kushtuar afér 100 mijë euro. Të gjitha rrugicat që dalin në ato lagje janë aktualisht në proces asfaltimi.

Po ashtu, asfaltimi i rrugës Duhel-Topillë-Grajçevc-Papaz ka qenë një projekt i nisur që në vitin 2017, por që deri tani nuk kishte pasur përparim. Është rigjeneruar gati me një vlerë rrëth 1 milion euro dhe punimet po zhvillohen në mënyrë intensive, në gjatësi mbi 3.4 km. Dje, në takimin që pata me operatorët, u tha se pritet që diku në mes të gushtit ky projekt të jetë funksional dhe të lidhen të gjitha këto fshatra të bukura që i kemi si komunë.

Sa i përket problemit të kanalizimit në lagjen pas shkollës filllore “Te Pishat”, aty ka pas mungesë kanalizimi, dhe megjithëse është afér parkut të pishave, qytetarët nuk kanë mundur të jetojnë për shkak të kundërmimit. Tashmë janë investuar mbi 1.4 km kanalizim, dhe aktualisht

janë duke u kryer segmentet e vogla të kyçjes. Ky është një projekt me ndikim të madh për përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë lagje.

Asfaltimi në rrugën “Industria”, në zonën ekonomike, prej rrerhrotullimit te lulishtja, ka përfunduar siç e keni parë dhe është një investim me vlerë afro 157 mijë euro, me kwtw rast ftoj veçanërisht edhe bashkatdhetarët që të investojnë në Komunën e Shtimes, sepse tashmë ekzistojnë kushtet bazike për investime të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik lokal.

Po ashtu, është bërë rregullimi i trotuareve në Petrovë, Belinc, Mollopolc, Davidovc, Lagjen e Pajtimit dhe disa lagje të tjera të komunës, pothuajse kanë përfunduar të gjitha.

Sa i përket asfaltimit të rrugëve nëpër fshatra, kemi pasur fatin të lidhim një kontratë në vlerë prej 1.9 milionë euro, dhe siç e keni parë, në të gjitha fshatrat dhe lagjet e qytetit është duke u punuar. Janë rrëth 30 km rrugë që po implementohen, dhe deri në fund të shtatorit gati 90% e rrugëve në fshatra do të janë të përfunduara.

Një tjetër investim është ndriçimi publik rrëth 105 mijë euro vetëm në gjashtëmujorin e parë, pas atij investimi të madh që kemi realizuar nga përfitimi i grantit të performancës, përmes së cilit janë realizuar 39 km ndriçim.

Në arsim, kemi gjetur 24 bursa dhe këtë vit i kemi çuar në 120 bursa për studentët dhe nxënësit tanë.

Një ngjarje e mirë është edhe themelimi i Ndërmarrjes Komunale “Ekosistemi”. Ne kemi shumë kontrata, ku jo vetëm që paguajmë shtrenjtë, por edhe cilësia nuk është e duhura për mirëmbajtjen e infrastrukturës, parqeve, ndriçimit, etj. Prandaj, kemi kalkuluar që kemi nevojë për një ndërmarrje komunale. Kjo do të mundësojë jo vetëm krijimin e vendeve të reja të punës për qytetarët tanë, por edhe ofrimin e shërbimeve me efikasitet më të lartë dhe kosto më të ulët sesa përmes kontraktorëve privatë. Jemi në fazën e themelimit; është dashur të përmbyllt brenda dy viteve, por shumë shpejt do të formohet bordi dhe do të bëhet thirrja për 15 punëtorë, duke marrë kompetencat dhe duke rritur kapacitetet.

Në botimin e librave, kemi qenë mbështetës çdo vit janë ndarë 5,000 euro për disa tituj që presim të botohen.

Në fushën e kulturës dhe rinisë, janë ndarë 25,000 euro për OJQ-të dhe 70,000 euro për 19 klube sportive, që do të thotë një total prej 100,000 euro. Duhet kujtuar se, kur e kemi marrë, kjo mbështetje ka qenë rrëth 30-33 mijë euro pra, e kemi trefishuar subvencionimin për kulturën, rininë dhe sportin.

Është hapur biblioteka në shkollën profesionale.

Janë 250 nxënës që përfitojnë kurse falas përmes bashkëpunimit me "Flutura Academy". Këto aktivitete zhvillohen në Qendrën e Inovacionit, ku nxënësit tanë përveç shkollimit bazik, marrin edhe shkathtësi shtesë përmes kurseve të gjuhëve të huaja, teknologjisë informative dhe programeve të tjera inovative.

Deri më tani, janë 119 lehona që kanë sjellë në jetë fëmijët e tyre. Si komunë, kemi menduar t'i ndihmojmë në total me 18,700 euro dhe me këtë mbështetje do të vazhdojmë.

Është rritur mbështetja për familjet strehuese në 150 euro në muaj. Ne e dimë që në Shtime janë rreth 3 familje që rrisin fëmijë pa prindër. Për këtë gjest human, si qeverisje lokale kemi vendosur që t'i mbështesim me këtë shumë modeste, por domethënëse. Një zonjë është kujdesur së bashku me familjen e saj për 48 fëmijë, një zonjë tjetër për 29, dhe tani një zonjë e re po rrit fëmijën e dytë ose të tretë.

Aktivitetet e rehabilitimit të familjarëve të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës po vijojnë për vitin e dytë, si shenjë mirënjojjeje dhe respekti për sakrificën dhe kontributin e tyre për lirinë që gëzojmë sot.

Themelimi i korit të qytetit është gjithashtu një ngjarje për t'u veçuar, një hap i rëndësishëm për pjesën kulturore dhe artistike të komunës sonë.

Mirëmbajtja e varrezave dhe hapësirave të gjelbra është tashmë në vitin e dytë të zbatimit dhe është pritur mjaft mirë nga qytetarët. E kemi parë që në kulturën tonë kemi mjaft të theksuar kujdesin për shtëpitë dhe oborret, por në këtë aspekt shpesh kemi lënë pas dore hapësirat publike. Prandaj e kemi parë të nevojshme që edhe këto hapësira të mirëmbahen të paktën 2-3 herë në vit, përmes një kontrate që tashmë është funksionale.

Gurthemeli i fazës së dytë të kanaleve kulluese, që po financohet nga Ministria e Bujqësisë, ka nisur para dy javësh. Ky projekt kap vlerën prej rreth 500,000 mijë eurosh dhe do të përfshijë edhe 5 km të tjera nga Davidovci, përkatësisht Gjyrkovci, deri në përfundimin e kanalit kullues që lidh tokat e Shtimes.

Tregu i gjelbër është një kontratë që kemi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Ata subvencionojnë projekte çdo vit, kjo është tashmë faza e tretë dhe përfundimtare. Vitin e parë dhe të dytë na janë dhënë fonde të ndara, ndërsa kësaj radhe, në fazën e fundit, na janë ndarë 635,000 euro. Aktualisht jemi në fazën e ndjekjes së procedurave të prokurimit dhe shumë shpejt do të nisë zbatimi. Brenda këtij viti, tregu do të jetë funksional për të gjithë bujqit e vendit tonë.

Përurimi i rrugës Pjetërshticë-Dugë-Karaçicë u bë më 12 qershor, në nderim të Ditës së Çlirimtë komunës sonë. Rruga është e gjatë 4.2 kilometra dhe e gjerë 4 metra, me një kosto prej rreth 450,000 eurosh. Ajo lidh fshatin Karaçicë-Dugë me fshatin Pjetërshticë, përkatësisht Carralevë.

Për hir të së vërtetës, në fshatrat malore kemi investuar rreth 5 milionë euro përfshirë këtë rrugë, rrugën e Topillës, rrugën e Rancës dhe Unazën e Madhe. Në këtë mënyrë, të gjitha fshatrat që dikur ishin të braktisura në aspektin infrastrukturor po i rikthehen gjallëria dhe zhvillimi. Përmes këtyre rrugëve, ne nderojmë edhe luftën tonë çlirimtare, sepse e dimë që pikërisht në këto rrugë kanë operuar ushtarët e UÇK-së dhe dëshmorët tanë.

Brenda qytetit tonë, po investohen aktualisht rreth 17 milionë euro, një sasi e konsiderueshme që e kemi përmendur edhe më parë.

Në kuadër të vlerësimit të figurave dhe ngjarjeve të rëndësishme, këtë vit kemi ndarë çmimin “Nderi i Qytetit” për profesor Fadil Hysaj dhe profesor dr. Ismail Hasani, dy personalitete me kontribut të jashtëzakonshëm në jetën akademike dhe kulturore të komunës sonë.

Asfaltimi i rrugës Llanishtë–Devetak–Shtime lidhet me një nga fshatrat më të bukur dhe me ndikim të fortë në historinë tonë kombëtare. Prandaj me plot respekt përmendim edhe dy figura madhore të atij vendi heroin e kombit Ilir Devetaku dhe profesor Ismail Hasanin.

Në Pjetërshticë, kemi realizuar një investim në ndriçimin modern të fushës sportive, që do të përmirësojë ndjeshëm kushtet për zhvillimin e aktiviteteve sportive gjatë mbrëmjeve, sidomos për të rinjtë dhe klubet lokale që tashmë kanë hapësira më të sigurta dhe funksionale për stërvitje e gara.

Projektet në procedurë të realizimit; e dimë që gjashtëmujori i parë shpesh ka sfida për shkak të kushteve meteorologjike dhe procedurave të prokurimit. Por tash që vera ka ardhur, jemi në fazë aktive të realizimit. Aktualisht jemi në procesin e asfaltimit të rrugëve Adem Jashari dhe Tahir Sinani, rrugës “Hysiqi”, që do të shkojë deri në tranzitin që ndan Davidovcin me Rashincën, rrugës “Berlini”, nga rrerhrotullimi i Lagjes së Pajtimit deri te “Pishat”, rrugës Carralevë-Zborc, që do të investohet për të lidhur këto dy fshatra.

Të gjitha këto projekte janë prova se vera në komunën tonë nuk është sezoni pushimi, por sezoni pune dhe pëershpejtimi të zhvillimit.

Një projekt që sapo kemi mbajtur takimin për të është ndërhyrja në varrezat e dëshmorëve dhe veteranëve në komunën e Shtimes. Ky është një investim me vlerë mbi gjysmë milioni euro, që më në fund do t'i japë këtij vendi të shenjtë pamjen dhe dinjitetin që e meriton, një kompleks i mirëfilltë, për nder e kujtim të përjetshëm për bijtë e kombit.

E për ta përmbyllur me një simbol urban të së ardhmes, është edhe projekt i për sheshin e qytetit, me një vlerë prej 3 milionë eurosh. Objekti ku ndodhemi sot dhe ai përballet do të rrënohen. Fillimisht do të ndërtohet një parking nëntokësor dhe, në pranverën e ardhshme sapo

administrata të zhvendoset në objektin e ri të komunës do të rrënohet edhe ky objekt i vjetër, për t'i hapur vendin një sheshi të bukur, modern dhe funksional në shërbim të qytetarëve tanë.

Të nderuar qytetarë, drejtorë, bashkëpunëtorë dhe të gjithë ju që jeni këtu sonte, Ky takim nuk është vetëm një formë raportimi, por është një dëshmi e asaj që bashkë po ndërtojmë, një komunë që po ec përpara, me hapa të sigurt dhe me punë konkrete. Në këta 6 muaj të parë të vitit, kemi qenë dëshmitarë të shumë projekteve që tashmë janë realizuar, e shumë të tjera që janë në zbatim. Nga infrastruktura rrugore, kanalizimi, arsimi, zhvillimi ekonomik, rinia, kultura puna është bërë në çdo drejtim.

Po, nuk ka qenë gjithçka e lehtë. Por kur ka vullnet, kur ka bashkëpunim, kur qytetari është në qendër të vendimeve tona, gjërat lëvizin. Dhe unë sot, si kryetar i kësaj komune, ndjehem me të vërtetë krenar për punën e bërë, por edhe i vetëdijshëm që ka ende shumë për të bërë. Nuk jemi këtu me u lavdëru. Jemi këtu me fol realitetin. Ka projekte që kanë ec mbarë, ka edhe sfida që na kanë dalë përpara por kurrë nuk kemi ndal së punuari. Nuk kemi ndal me besu që kjo komunë meriton më shumë dhe më mirë. Të gjithë ju që jeni këtu, jeni pjesë e kësaj rruge. Pa drejtorët, stafin komunal, qytetarët që na mbajnë në llogaridhënie, pa ju ky progres nuk do të ishte i mundur. Në muajt që po vijnë, do të vazhdojmë edhe më fuqishëm. Po e forcojmë zhvillimin ekonomik, po punojmë për kushte më të mira në arsim e shëndetësi, dhe mbi të gjitha, po ndërtojmë një komunë ku qytetari ndihet pjesë aktive e çdo procesi.

Ju faleminderit për mbështetjen, për kritikat, për idetë, të gjitha na ndihmojnë me qenë më të mirë. E përfund, një thirrje: le ta vazhdojmë këtë rrugë bashkë. Sepse komuna jonë nuk ndërtohet vetëm nga zyret, por nga të gjithë ne me punë, me besim, dhe me dashni për vendin tonë.

Nëse ka ndokush diçka nga ju për të shtuar, me pyt, ose ndonjë koment tash është momenti. Jam këtu me ju ndëgju, edhe ju falënderoj për vëmendjen dhe bashkëpunimin.

Pas përfundimit të fjalës së Kryetarit, fjalën e mori qytetari Hysen Hoxha.

Hysen Hoxha (qytetar): Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Jam Hysen Hoxha, me profesion inxhinier i makinerisë, dhe vij nga fshati Gjyrkovic. Më vjen mirë që ka interesim për komunën tonë dhe për punën tuaj si kryetar. Me dashtë vendin është diçka e madhe por me e mbrojt dhe me punu për të, është edhe më madhështore. Dua t'i falënderoj edhe bashkëpunëtorët tuaj. Jam kthyer nga mërgimi para dy vitesh, pas 36 viteve të kaluara atje. Ndjehem i kënaqur me punën që është bërë në komunën tonë shumë punë janë realizuar dhe shumë të tjera po vazhdojnë. Një shqetësim konkret që dua të ndaj është mungesa e përkujdesjes së operatorëve ekonomikë, të cilët, pas përfundimit të punimeve, nuk i pastrojnë mbeturinat që lënë pas. Kjo gjë jo vetëm që dëmton imazhin e punës së mirë që bëhet, por edhe ndikon në ambientin dhe mirëqenien e qytetarëve.

Kryetari, Dr.Qemajl Aliu: Faleminderit shumë edhe për vlerësimin, komentet dhe sugjerimet. Për hir të së vërtetës, edhe ne e kemi sfidën me operatorët. Në Komunën e Shtimes, aktualisht kemi vetëm dy inxhinierë. Administrata është e rraskapitur, duke u marrë edhe me probleme dytësore e tretësore, për të cilat shpesh nuk ka as mbulim financiar. E kuptoj plotësisht çdo kritikë nga qytetarët dashamirës dhe po, me kapacitetet që kemi, jemi përpjekur t'i menaxhojmë të gjitha punët. Por jemi njerëz që punojmë, dhe çdo lëshim nuk është i qëllimshëm. Kur punohet shumë, ndodhin edhe gabime. Kjo është e vërteta. Dhe jemi këtu jo sepse jemi të pagabueshëm, por sepse jemi të përkushtuar.

Axhi Hysen, të falënderoj sinqerisht që je qytetar aktiv dhe prezent. Çështja e deponimit të mbeturinave është sfiduese dhe nuk është gjithmonë në dorën e komunës. Kemi raste ku qytetarë nuk janë në gjendje të paguajnë një taksë mujore prej 6.20 eurosh dhe i hedhin mbeturinat natën, madje edhe në lumë. Ne nuk jemi polici, as prokurori. Por po, kjo më mundon personalisht, sepse është një dobësi që jemi në rrugë për ta tejkaluar. Me reflektim njerëzor dhe ndërgjegjësim kolektiv, besoj fort që dita-ditës do të bëhet më mirë. Faleminderit, dikush tjetër ?

Nazmi Iballi: Përshëndetje për të gjithë! Sinqerisht, kjo që po shohim sot tregon një vijueshmëri profesionale, sidomos në aspektin financiar dhe ekzekutiv. Ju përgëzoj sinqerisht për punën e mirë. Ne që kemi punuar më parë në Prishtinë, na thoshin "hajt se në Shtime", por sot është ndryshe pamjet vizuale, raportet e punës dhe investimet konkrete tregojnë që Shtimja po ecën me hapa të sigurt. Tash kemi të drejtë të jemi krenarë që jemi nga Shtimja nëse nuk na xhelozojnë të tjerët. Nuk kam vërejtje përkundrazi, gëzohem shumë për projektet që po realizohen, sidomos për të rinjtë tanë. Ky objekt na ka penguar edhe në aspektin shoqëror, sepse nuk na ka zënë udhën si duhet. Po, kemi pasur sfida të jashtëzakonshme, por ajo që është arritur sot është po aq e jashtëzakonshme. Kur pashë se çka do të ndërtohet nëntokë dhe mbi tokë, u binda që kjo nuk është vetëm ndërhyrje fizike është zhvillim vizionar për qytetin tonë. Në të kaluarën kemi dështuar në mirëmbajtje te roja, te pajisjet, te detajet por është edhe çështje mentaliteti. Me ndërtimin e tribunave dhe rregullimin e fushës, shtohen jo vetëm funksioni, por edhe bukuria e qytetit si qershia mbi tortë! Edhe ato 120 bursa vazhdoni me to! Nuk janë vetëm një shifër, por janë investimi më i sigurt që mund të bëjmë: arsimi. Së fundmi, një fjalë për rrugën e dëmtuar në Carralevë të gjithë qytetarët pengohen aty. Korrizioni ka bërë të veten, por një zgjidhje stabile dhe e qëndrueshme me koordinim nga ministria do të ishte shumë e nevojshme. Unë ju përgëzoj nga zemra. Nuk jam pjesë e asnjë partie politike dhe mbështetje kjo më jep më shumë liri për të gjykuar drejt. Po e them si qytetar i pavarur: të mirat për komunën e Shtimes duhet të vazhdojnë. Faleminderit!

Kryetari, Dr.Qemajl Aliu: Faleminderit shumë, bacë Nazmi, për çdo vlerësim. Jam shumë i lumtur që këto fjalë po i dëgjoj nga goja e një profesionisti dhe intelektuali si ju. Ju vetë i keni kaluar këto fazë dhe jeni pjesë e rëndësishme intelektuale e qytetit tonë. Ndihem i vlerësuar.

Sa i përket asaj pike që përmendet po, është një ndër pikat që sa herë kaloj aty, më ngjallet një ndjenjë frike, sepse realisht ka rrezik. Është e vërtetë që kjo rrugë bën pjesë në buxhetin e rrugëve regionale përkatësisht aksi Belinc-Carralevë-Duhel-Suharekë-Prizren. Edhe aty janë në pritje të përfundimit të procedurave, derisa të zgjidhet një operator ekonomik.

Ia kam përcjellë edhe ministrit Aliu këtë çështje, me theks të veçantë se kjo pjesë është vërtet urgjente. Segmentet e tjera kanë nevojë për renovim, por nuk janë në gjendje të rrezikshme ndërsa kjo pjesë për të cilën po flasim, duhet trajtuar si emergjencë. Po mundohemi ta ndajmë si lot më vete dhe ta shtyjmë për zbatim të menjëhershëm me të vetmin qëllim që të mos ndodh ndonjë fatkeqësi. Faleminderit edhe një herë, dikush tjeter?

Idajet Rexhepi (qytetar): Jam Idajet Rexhepi. Desha ta përgëzoj kryetarin për të gjitha punët që po bëhen, e që edhe ne po i shohim çdo ditë. Ajo që më gëzon më së shumti është se projektet janë të përbledhura në një vend dhe po paraqiten qartë jo vetëm si ide apo letra, por si punë konkrete që zhvillojnë infrastrukturën e komunës sonë. Përveç buxhetit nga niveli qendror, të gjitha këto ndërhyrje janë për çdo lëvdatë. Bie në sy që projektet janë shtrirë në të gjitha zonat e komunës në lagje, fshatra, dhe në pjesën urbane pa anashkalim, pa ndonjë qasje të padrejtë. Janë shpërndarë siç është më së miri, duke përfshirë shëndetësinë, kulturën, arsimin fusha për të cilat me të vërtetë mund të krenohemi dhe të vazhdojmë të investojmë. E inkurajoj kryetarin të vazhdojë me këtë potencial, dhe njëkohësisht do të doja të theksoja edhe një nevojë për më shumë angazhim në rritjen e efikasitetit të punës në administratë jo vetëm në komunë, por në çdo nivel të shërbimeve publike. Rritja e përgjegjësisë institucionale do ta begatonte edhe më shumë punën tuaj të mirë. Faleminderit!

Kryetari, Qemajl Aliu: Faleminderit për vlerësimin dhe për kontributin sepse jeni pjesë e rëndësishme e komunës sonë. Disa kolegë ndoshta po na shikojnë me pritshmëri më të larta, ndoshta edhe me qëllim që të na “shtrëngojnë”, me synimin që të arrijmë edhe më shumë dhe kjo është në rregull. Gjithmonë ka vend për më mirë. Unë personalisht nuk dua të arsyetoj dobësitë e mijë jemi njerëz, dhe kur ka ngarkesa të mëdha, ndodhin edhe lëshime. Por besoj fort që çdo ditë po punojmë me më shumë përgjegjësi dhe përgjegjshmëri.

Nëse ka dikush tjetër që dëshiron të flasë, me kënaqësi. Përndryshe, ju faleminderit shumë për pjesëmarrjen, për vërejtjet, për idetë dhe për kohën që keni ndarë sot për komunën tonë.

Mirëupafshim në takimet e radhës! Mbledhja ka përfunduar në ora 16:20!

Procesmbajtës:

Vlora Hyseni





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
/KANCELARIJA PRESEĐNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE












ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT TË KOMUNËS
SË SHTIMES DR.QEMAJL ALIU PËR GJASHTË MUJORIN E PARË-2025**

Shtime, 27 qershor 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Bikenber Seliti	Rastësia	Luigj
2	Egzon Selmani	Qytetar	Celj
3	VISHRE BRAHIMI	QYTETAR	Abdullah
4	AGJHI MUSTAFË	QKMF	Rezul
5	ILAZ KAZRJAS	DKMF	Elizaj
6	Mornute Hasumi	QKMF	Hasumi
7	Bekir Sofri	Qytetar	Bekir
8	Ahet Vukeli	Qytetar	Vukeli
9	Nebili Mokrobo	Qytetar	Nebili
10	Miftari u Gruas	Qytetar	Miftari
11	ALBAN HAJRUSHI	QYTETAR	Alban Hajrushi
12	Splejtim Tërkang	Qytetar	Splejtim Tërkang

13	Hauq Kurković	K. Shtime	
14	Sultjan Muhameti	K. Shtime	
15	Safet Brahimović	K. Shtime	
16	Ibniz Mehmeti	K. Shtime	
17	HUSEN HOVHA	Ambientalist	
18	ADAM PARADANI	QPS.	
19	Nazmi Isaković	Osteter	
20	Majstor Rexhepi	Vredni	
21	FLORIJE HISEN,	K. SHTIME	
22	HANIFET Hekmat	K. SHTIME	
23	Jumic Ahm	K. Shtime	
24	SANIJE SADIK	PESHTAR KOMUNAL	
25	Hajir Dugjhi	Pridreptati	
26	Yuri Benloli	K. KOMUNAL	
27	Besarta Rexhepi Sinani	K. Komunal	
28	Gonxhe Osmani	K. Shtime	
29	Donald Ramaj	Drm	
30	SHERIF FAZLISH	K. SHTIME	
31	Mir Ferizullah	K. Shtime	
32	Mavim Hasemi	K. Shtime	
33	Zamri Zauri	KR. Shtime	

34	Shpetim Gashi	K. Shtime	SHG
35	Tanya Khrelili	K. Shtime	Fudičić
36	Mlana Tuzeni	Zgjedha për info	Hanafi
37	Admire Selmani	Zgjedha bojçesës	HumJ.
38	Valmira Hoxha	K. Shtime	Pavlović
39	Agnesa Ademaj	K. Shtime	Ajroš
40	DRITON LATIFI	Z.I.P.	Belić
41	FLAMUR MUHADI	K. Shtime	F. M
42	Adem Ramadani	Godanci, grërm	Ajroš
43	Shpetim Sebeni	Shtime	Belani
44	Faton Shogiri	Godanc	Shogiri
45	Adem Aleji	Godanc	Lekić
46	Freskim Agjin	CHEALEVË	Jurka
47	Edon Hyseni	Qytetar	Edon Hyseni
48	Mustaf Halili	K. Shtime	Mustaf Halili
49	Efzedim Halili	Godanci	Efzedim Halili
50	VISAR TERSHANI	SHTIME	Visar Tershani
51	Herdina Sekmani	SHTIME	Sekmani
52	Dordon Horli	Godanc	Dordon Horli
53	Adharion Maksuti	Godanc	Adharion Maksuti

54	Zefnje Velmi	centim	Vellini
55	Albana Fazlija	Kultare	Mesfina
56	Yllka Fejzullahu	DKA	Mihal
57	Lutzim Sahiti	DKA	Jef
58	IMRI HOXHA	DAP	Slim
59	Haxit Kurkoci	ADM	Bashiri
60	Armenend Imeni	ADM	Armenend
61			
62			
63			
64			
65			
66			
67			
68			
69			
70			
71			
72			
73			
74			





